



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

1678/2  
Nr. \_\_\_ Prot.

Tiranë, më 22/04/2024

URDHËR

Nr. 214, Datë 22 .04 .2024

**“PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 619, DATË 23.11.2022, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR PËRZGJEDHJEN E INSTITUCIONEVE TRAJNUESE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT PËR KANDIDATËT PËR NDËRMJETËS TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9/2022 “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, si dhe urdhrin të Ministrit të Drejtësisë nr. 184, datë 04.05.2022 “Për miratimin e rregullore së programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”,

**URDHËROJ:**

- Në urdhrin nr. 619, datë 23.11.2022, të Ministrit të Drejtësisë, “Për përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, shtohen si institucione trajnuese:
  - **Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë**
  - **Universiteti European i Tiranës**
- Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri, **Universitetit Mesdhetar të Tiranës, Universitetit European të Tiranës dhe Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB).**
- Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
ULSI MANJA  
  
